



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 1565/5 prot.

Tiranë më 16.11.2018

VENDIM

Nr. 65, datë 16.11.2018

MBI

ZBATIMIN E LIGJIT PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Universiteti i Tiranës*".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr. 265 datë 19.10.2018 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "*Universiteti i Tiranës*", me objekt:

- Verifikim i zbatimit të Rekomandimit Nr. 12 datë 22.05.2017 të Komisionerit, Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit "*Universiteti i Tiranës*".

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*Universiteti i Tiranës*", konstaton se nuk janë zbatuar detyrimet ligjore të përcaktuara në Rekomandimin Nr.12/2017 të Komisionerit të cilat konsistojnë në:

1. Kontrolluesi nuk ka hartuar rregullore mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video dhe funksionimin e sistemit të video-survejimit (CCTV), sipas kriterëve të parashikuara në pikën e parë të Rekomandimit Nr. 12/2017 të Komisionerit. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të Ligjit Nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave*

Personale", pika 2/1: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera."

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi rregullores dhe udhëzimeve specifike për operatorët e autorizuar, në lidhje me përpunimin e të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV), me qëllim marrjen e masave organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

2. Kontrolluesi nuk ka hartuar aneksin e kontratës në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale, sipas kritereve të parashikuara në pikën e dytë të Rekomandimit Nr. 12/2017 të Komisionerit, dhe në Udhëzimin Nr. 19/2012 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi". Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 20 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale":

"1. Kontrolluesit, për përpunimin e të dhënave personale, mund të punësojnë përpunues, të cilët garantojnë përdorimin e ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave. Çdo përpunues i të dhënave personale ka këto detyrime:

a) të përpunojë të dhënat vetëm në përputhje me udhëzimet e kontrolluesit; të mos i transmetojë ato, përveç kur ka marrë udhëzim nga kontrolluesi....."

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin (datë 06.11.2018), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit e ka nënshkruar me komentin: "Rezervojmë të drejtën për të parashtruar shpjegimet brenda afatit 3 ditor".

Në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Universiteti i Tiranës" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë, por nuk ka dokumentuar rikuperimin e shkeljeve administrative të konstatuara në kontrollin e ushtruar pranë tij. Kontrolluesi ka paraqitur si provë Vendimin Nr. 215 datë 11.09.2015 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda nëpërmjet të cilit është vendosur sekuestrimi i të dhënave kompjuterike që mban sistemi kompjuterik i Rektoratit të Universitetit të Tiranës, çka sjell pamundësi ligjore për plotësimin e këtij detyrimi ligjor të përcaktuar në pikën e dytë të Rekomandimit Nr. 12/2017 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se shkeljet e konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar në vitin 2017 pranë kontrolluesit "Universiteti i Tiranës", duhej të rikuperoheshin brenda afatit 10 ditor, sipas pikës së tretë të Rekomandimit Nr. 12/2017 të Komisionerit.

Si përfundim shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në lidhje me mungesën e rregullores specifike "Për përpunimin e të dhënave nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV)", në kuptim të nenit 39, pika 1, gërma "dh" të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", përbën kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

"Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10000 deri në 150000 lekë"

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 27, 29, 30, 39 pika 1 gërma "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale",

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Universiteti i Tiranës", me gjobë në vlerën 20.000 (njëzetmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuara në nenin 27 të Ligjit Nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale".
2. Kontrolluesi "Universiteti i Tiranës", të respektojë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në nenin 20 të Ligjit Nr.9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe Udhëzimin Nr. 19/2012 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi". në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave personale.
3. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
4. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 16.11.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

